

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7064
E enjte, 7 dhjetor 2023
Çmimi 0.50 €

Tradita e shtegtimit të bagëtive në Shqipëri mbrohet nga UNESCO 1 PAGE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (12)

TAKIMI I PARË I UÇK-së ME DIPLOMATËT AMERIKANË

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së dymbëdhjetë, ka folur për takimin e parë të UÇK-së me diplomatët amerikanë. "Më 16 qershor 1998, fiks në orën 9:00, ishim në vendin e paraparë. Na u afruan dy persona dhe pasi na përshëndetën, kërkuan të siguroheshin nëse ishim personat me të cilët kishin takim. Kur u siguruan për identitetin tonë, na thanë se bisedimet do të zhvilloheshin gjetiu dhe na lanë takim në hyrje të një hoteli të Gjenevës, një orë më vonë", tregon Bardhyl Mahmuti, për të vazhduar tutje se ishin tetë diplomatë që i prisnin në hyrje të sallës. Ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së ka theksuar se disa muaj pas takimit të parë me diplomatët amerikanë, së bashku me Jashar Salihun, Ramadan Avdiun dhe Agush Bujën mbajtën një konferencë me gazetarë të akredituar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë



OPINION

RECENZION: ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSO MADHE (1856-2022) **F. 9**

Prof. dr. Muhamet Mala



AKTUALE



BRITANIA VË SANKSIONE NDAJ FURNIZUESVE TË USHTRISË SË RUSISË **F. 2**

TAHIRI TAKON VIOLA VON CRAMON: ANËTARËSIMI NË NATO DHE BE I KOSOVËS DUHET TË JETË FOKUSI KRYESOR **F. 7**

HAPET JAVA E TË DREJTAVE TË NJERIUT **F. 7**

EKONOMI



PARAQITET MASA 1.2 PËR SUBVENÇIONIMIN E BLERJES SË LËNDËS DJEGËSE PËR DIMËR **F. 8**

KËRKOHET DREJTËSI PËR LIRIDONËN E SIGURI PËR GRATË **F. 7**



PDK-ja: PISA ËSHTË PASQYRA E VËRTETË E QEVERISË KURTI, NAGAVCI TË JAPË DORËHEQJE **F. 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Britania vë sanksione ndaj furnizuesve të ushtrisë së Rusisë

LONDËR, 6 DHJETOR - Britania të mërkurën ka njoftuar vendosjen e 46 sanksioneve të reja kundër individëve dhe grupeve nga vende të ndryshme, që ajo ka thënë se kanë qenë të përfshira në zinxhirët furnizues të ushtrisë ruse dhe se e kanë ndihmuar Rusinë në vazhdimin e luftës në Ukrainë.

Ndër të sanksionuarit janë entitete që operojnë në Kinë, Turqi, Serbi dhe Uzbekistan, ka thënë Ministria e Jashtme e Britanisë.

Britania e ka mbështetur vendosmërisht Ukrainën që kur Rusia e pushtoi atë në shkurtin e

vitit 2022, dhe ka thënë se po merr masa ndaj furnizuesve nga vendet e treta, për ta kufizuar aftësinë e Rusisë për anashkalimin e sanksioneve ekzistuese, raporton "Reuters". "Ne do të vazhdojmë ta rritim tryshninë ndaj Putinit dhe të marrim masa ndaj palëve të treta që po i ofrojnë Rusisë mallra dhe teknologji të ndaluar kudo që janë ato", ka thënë zëvendësministria e Jashtme britanike, Anne-Marie Trevelyan.

Britania ka thënë se ka sanksionuar 31 persona dhe entitete lidhur me dizajnimin

dhe prodhimin e dronëve dhe pjesëve të raketave, dhe me importimin e komponentëve elektronikë, dhe katër entitete me bazë në Emiratet e Bashkuara Arabe, që ajo ka thënë se janë të përfshira në tregtinë e naftës ruse.

Ndër 46 sanksionet e reja përfshihet edhe një ndaj Bjellorusisë. Ministria e Jashtme britanike ka thënë se ka vendosur sanksione ndaj një organizate bjelloruse të mbrojtjes, e cila prodhon teknologji ushtarake që përdoret nga Misnku për ta mbështetur Rusinë në luftën ndaj Ukrainës.



Luftimet e ashpra në Gazë pamundësojnë furnizimin me ndihma

GAZA, 6 DHJETOR - Forcat izraelite i vazhduan luftimet e ashpra me luftëtarët e Hamasit - i cilët është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara - nëpër Rripin e Gazës të mërkurën, pasi e kanë zgjeruar ofensivën tokësore në qytetin e dytë më të madh të kësaj enklave, duke e tkurrur vendin ku palestinezët mund të kërkojnë strehim dhe duke e pamundësuar fuqizimin me ndihma jetike nëpër shumicën e vendit.

Ofensiva në jug kërcënon të shkaktojë zhvendosje të madhe të njerëzve brenda enklavës së rrethuar bregdetare, ku Kombet e Bashkuara thonë se 1.87 milion njerëz - rreth 80 % e popullsisë - kanë ikur nga shtëpitë e veta tashmë.



Shumica e veriut, përfshirë pjesë të mëdha të qytetit të Gazës, është shkatërruar plotësisht, dhe palestinezët kanë frikë se edhe pjesa tjetër e Gazës mund ta përjetojë fatin e

njëjtë. Izraeli thotë se i duhet patjetër ta rrëzojë Hamasin nga pushteti për ta parandaluar përsëritjen e sulmit të 7 tetorit në jug të Izraelit, ku Hamasi dhe

militantët e tjerë i vranë rreth 1 200 njerëz, kryesisht civilë, dhe i morën 240 pengje.

Më shumë se 100 pengje janë liruar tashmë gjatë armëpushimit njëjavor, ndërsa Izraeli i liron 240 të burgosur palestinezë.

Kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, ka thënë se Izraeli do të mbajë kontroll të pakufizuar të sigurisë në Rripin e Gazës, megjithëse kjo është kundërshtuar nga Shtetet e Bashkuara dhe shumica e komunitetit ndërkombëtar.

Në tri ditët e fundit furnizimi me ndihma - kryesisht miell dhe ujë - ka qenë i mundur vetëm brenda dhe përreth qytetit kufitar, Rafah, në skajin jugor të Gazës, për shkak të

luftimeve dhe mbylljes së rrugëve nga forcat izraelite, sipas OKB-së.

Gaza ka mbetur pa rrymë prej fillimit të tetorit, ndërsa Izraeli ka kufizuar skajshëm importin e karburantit, duke i detyruar disa spitale të mbyllen, sepse ato kanë mbetur edhe pa gjeneratorët emergjentë.

Lufta i ka vrarë më shumë se 16 200 njerëz në Gazë - 70 për qind gra dhe fëmijë - dhe i ka plagosur mbi 42 000, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së këtij territori, e cila i publikoi të dhënat e reja të martën.

Ushtria e Izraelit e akuzon Hamasin se po i përdor civilët si mburoja njerëzore gjatë operacioneve të luftëtarëve të vet në zonat e banimit.

Protestuesit në Iran u dhunuan dhe u abuzuan seksualisht, sipas Amnesty International



TAHRAN, 6 DHJETOR - Forcat iraniane të sigurisë i kanë përdorur dhunimin dhe llojet e tjera të abuzimit seksual për t'i frikësuar protestuesit gjatë luftës së shtetit kundër protestave gjithëkombëtare, të cilat nisën shtatorin e kaluar me moton: "Gra, Jetë, Liri", tha Amnesty International në një raport më 6 dhjetor.

Dhuna seksuale u përdor kundër

grave, burrave dhe fëmijëve, sipas raportit të Organizatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, i cili dokumentoi vuajtjet e tmerrshme të 45 të mbijetuarve. Në mesin e të intervistuarve në raport ishin 26 burra, 12 gra dhe shtatë fëmijë, ndaj të cilëve forcat iraniane të sigurisë kryen dhunë seksuale.

Asnjë zyrtar iranian nuk është akuzuar deri tani, apo përndjekur

për krimet seksuale kundër protestuesve të burgosur, thuhet në raport.

Gratë iraniane u kanë prirë protestave gjithëkombëtare, të cilat u nxitën nga vdekja e 22 vjeçes Mahsa Amini në paraburgimin policor në shtator të vitit të kaluar. Amini ishte arrestuar në Teheran për shkak se gjoja nuk e kishte veshur siç duhet hijabinin.

Rumania shpall epidemi të fruthit

Ministria e Shëndetësisë e Rumanisë ka shpallur epidemi të fruthit në nivel kombëtar pas rritjes alarmante të rasteve në të gjithë vendin. "Ministria

shpall një epidemi kombëtare për ta lehtësuar vaksinimin e fëmijëve mes 9 dhe 11 muajsh dhe të fëmijëve më të rritur që nuk janë vaksinuar ende", thuhet në një deklaratë të

Ministrisë rumune të Shëndetësisë.

Ndër të tjera, aty shtohet se ishin afër 2 000 raste të reja në 29 nga 41 qarqet e Rumanisë. Rumania është përballur me

rënie të vazhdueshme të numrit të fëmijëve të vaksinuar kundër fruthit, që është nxitur nga fushatat kundër vaksinimit të fëmijëve nëpër mediet sociale.



PDK-ja: PISA është pasqyra e vërtetë e qeverisë Kurti, Nagavci të japë dorëheqje

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Pas publikimit të rezultateve të testit PISA, ku Kosova u radhit pothuajse në fund të tabelës, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) vlerëson se u konfirmua zyrtarisht se analfabetizmi qeveritar nuk arriti ta reformojë sistemin arsimor në Kosovë. Deputetja e PDK-së, Eliza Hoxha, në një konferencë për medie tha se me qeverinë Kurti në tri vitet e fundit, kriza në arsim vetëm sa është thelluar edhe më shumë. “Nuk mund të presim përmirësim të cilësisë në arsim kur qeveria Kurti me veprimet e saj ka vendosur në pikëpyetje kredibilitetin e pothuajse secilit mësimdhënës në Kosovë. Në vend se t’u ofroj mbështetje për zhvillim, të aftësive dhe shkathtësive të reja të kohës, siç kishte premtuar, e për të cilat fëmijët tanë kanë kaq shumë nevojë. Çfarë na dëshmohej ne sot, është që nxënësit ngarkohen me libra e informata sasiore, por jo me zhvillim dhe përgatitje cilësore. Dhe kjo i atribuohet kësaj qeverie e cila pushtetin e ka marrë duke u thirrur në reformë, por me logjikën si kanë funksionuar këto tri vite, kanë dështuar jo vetëm ata, por ka dështuar edhe Kosova. PISA sot është pasqyra e vërtetë e



qeverisjes së Albin Kurtit”, tha ajo. Hoxha theksoi se Ministria e Arsimit jo vetëm që nuk ka bërë reforma në sistemin arsimor, por edhe i ka penguar ato. “Po hyjmë në vitin e fundit të kësaj qeverie, dhe 160 çerdhet e premtuara as afër nuk janë. As 10 sosh nuk janë ndërtuar. Nuk ka pasur asnjë

reformë në arsimin fillor. Për më tepër, në vend që të bëjë reforma, zgjodhi që të luftojë nga njëra anë mësimdhënësit, e këtë vit nuk i doli zot as obligimit kushtetutes dhe ligjor, që të sigurojë falas librat për nxënësit e Kosovës. Po ashtu, besoj ju kujtohet lufta që ministria Nagavci i kishte bërë kryetarit të

komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, në reformën e tij për arsimin fillor, duke i tejkaluar kompetencat e saj dhe duke shkelur Kushtetutën e Kosovës. E sa për digitalizim e inovacion, as që është diskutuar ndonjëherë nga kjo qeveri dhe as nuk ka ndonjë lëvizje”, tha ajo. Ndërsa anëtar i kryesisë së PDK-

së, Muzafer Shala, tha se pas të gjeturave shqetësuese të nxjerra nga PISA, Ministria e Arsimit është dashur qysh sot të japë dorëheqje. “Qeveria e Kosovës urgjentisht duhet të bëjë prioritet adresimin e problemeve të cilat i ka evidentuar PISA”, shtoi ai. PDK-ja i ka propozuar Qeverisë së Kosovës nëntë rekomandime, të cilat ata duhet të adresojnë urgjentisht. Përmirësimi i arsimit në matematikë, lexim dhe shkencë: “Shkollat duhet të fokusohen në forcimin e kurrikulave të tyre të matematikës, leximit dhe shkencave, duke përfshirë më shumë mundësi mësimore praktike dhe të aplikuara. Mbështetja e studentëve me arritje të ulëta: Të ketë ndërhyrje të synuara dhe mbështetje për nxënësit me arritje të ulëta, të cilat ndihmojnë në ngritjen e nivelit të performancës së tyre. Ngushtimi i hendekut të performancës: Të bëhet përpjekje e vazhdueshme për të mbështetur ata me arritje të ulëta, duke ofruar sfida për ata me arritje të larta. MASHTI duhet të zhvillojë strategji për t’i mbështetur nxënësit me prejardhje të pafavorshme, duke siguruar që ata të kenë qasje në mjetet e konkretizimit dhe mbështetjen që u nevojitet për të pasur sukses”, janë disa nga rekomandimet e PDK-së për arsimin, të cilat i propozoi Shala.

Tradita e shtegtimit të bagëtive në Shqipëri mbrohet nga UNESCO

Tiranë, 6 dhjetor - Komiteti Ndërqeveritar për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore e ka futur traditën e shtegtimit të bagëtive të Shqipërisë në listën e trashëgimisë kulturore botërore të UNESCO-s, njoftoi të mërkurën ministria e Kulturës e Shqipërisë, Elva Margariti. Për ta futur këtë traditë nën mbrojtjen e Organizatës Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNESCO), Shqipëria kishte aplikuar në një dosje të përbashkët me Italinë, Austrinë, Greqinë, Spanjën, Francën, Rumaninë, Kroacinë, Luksemburgun dhe Andorrën në mars 2022.

“Tradita e shtegtimit të bagëtive është një traditë e lashtë që ka kapërcyer shekujt dhe shtete; një mënyrë jetese e pasur me këngë pastorale, instrumente, veshje, rite, festa dhe kulinari”, shkroi Margariti në “Facebook”.

Në Shqipëri kjo traditë, e njohur në botë si Transhومانca, zhvillohet në zonat e thella malore në veri dhe në jug të vendit. Me nisjen e stinës së



verës, në qershor, barinjët me kopetë e bagëtive bëhen gati të udhëtojnë drejt bjeshkëve. Ata e njoftojnë njëri-tjetrin dhe nisin së bashku rrugëtimin për në

zonat e larta malore, ku qëndrojnë për tre muaj. Ata marrin me vete enë dhe pajisje për të mbledhur dhe përpunuar qumështin, qentë që ruajnë

bagëtitë, por edhe fyell apo çifteli e vegla të tjera muzikore, për të kaluar ditët dhe netët larg shtëpisë dhe familjes. Pas tre muajsh shtegtimi,

barinjët dhe kopetë e bagëtive kthehen në shtëpi, së bashku me ushqimet e grumbulluara gjatë kësaj kohe. Zakonisht për kthimin e tyre organizoheshin edhe festime. Kjo traditë rrezikon të zhduket për shkak të lëvizjes së banorëve të fshatrave drejt zonave urbane, por edhe për shkak të emigrimit jashtë vendit.

Ministria tha se ky vendim “do të jetë një ogur i mirë edhe për dosjet e tjera që Shqipëria ka dorëzuar pranë UNESCO-s”. Shqipëria ka dorëzuar kërkesat me dosjet përkatëse për “Kcimin e bjeshkës me tupan të Tropojës” dhe “Këndimin me lahutë të këngëve të kreshnikëve”, të cilat ende nuk janë shqyrtuar nga UNESCO.

Aktualisht pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s janë Gjirokastra, Butrinti, Berati, liqeni i Ohrit, lumi i Gashit në luginën e Valbonës, si dhe xhubleta.

Pak kohë më parë Shqipëria u zgjodh anëtare e Bordit Ekzekutiv të UNESCO-s për periudhën 2023-2027.



INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (12)

Takimi i parë i UÇK-së me diplomatët amerikanë

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së dymbëdhjetë, ka folur për takimin e parë të UÇK-së me diplomatët amerikanë. "Më 16 qershor 1998, fiks në orën 9:00, ishim në vendin e paraparë. Na u afruan dy persona dhe pasi na përshëndetën, kërkuan të siguroheshin nëse ishim personat me të cilët kishin takim. Kur u siguruan për identitetin tonë, na thanë se bisedimet do të zhvilloheshin gjetiu dhe na lanë takim në hyrje të një hoteli të Gjenevës, një orë më vonë", tregon Bardhyl Mahmuti, për të vazhduar tutje se ishin tetë diplomatë që i prisnin në hyrje të sallës. Ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së ka theksuar se disa muaj pas takimit të parë me diplomatët amerikanë, së bashku me Jashar Salihun, Ramadan Avdiun dhe Agush Bujën mbajtën një konferencë me gazetarë të akredituar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë

PRISHTINË, 6 DHJETOR-

"Epoka e re": Të flasim konkretisht për takimin e parë me diplomatët amerikanë. Na thotë se ishte paraparë të bëhej në Gjenevë. Çfarë mund të na thoni për atë takim? Ku u takuat dhe kush ishte në përbërje të delegacionit të tyre?

Bardhyl Mahmuti: Përkundër asaj se ka kaluar një çerek

shekulli nga ajo kohë, do të flas në mënyrë të përgjithësuar dhe nuk do të jap saktësi për vendtakimin. Megjithatë do të ndaj me lexuesin shqetësimin që patëm në momentin e vënies së kontaktit. Vendtakimi ishte caktuar në hyrje të një restoranti në Gjenevë. Më 16 qershor 1998, fiks në orën 9:00, ishim në vendin e paraparë. Na

u afruan dy persona dhe pasi na përshëndetën, kërkuan të siguroheshin nëse ishim personat me të cilët kishin takim. Kur u siguruan për identitetin tonë, na thanë se bisedimet do të zhvilloheshin gjetiu dhe na lanë takim në hyrje të një hoteli të Gjenevës, një orë më vonë.

U ndamë prej tyre dhe u nisëm

drejt vendtakimit tjetër. Për ta shtendosur atmosferën, Ramadan Avdiu tha si me të qeshur: "Me gjasë duka jonë nuk ua mbushi mendjen! Kur të shkojmë te vendi i caktuar nuk do të gjejmë asnjë diplomat"! Në hyrje të hotelit na prisnin personat që i takuam një orë më parë, të cilët me gjasë kishin qenë personel i Misionit diplomatik të ShBA-së në Gjenevë, sepse vetëm na shoqëruan në një sallë të hotelit, rreth 100 m² dhe nuk morën pjesë në takim.

Ishin tetë diplomatë që na prisnin në hyrje të sallës. U prezantuam dhe zumë vend në një tavolinë të madhe në trajtë vezake. Përballë nesh u ul diplomatë që u prezantua si i ngarkuar i presidentit Bill Clinton, dhe në të dy krahët e tij ishin diplomatë të përfaqësive diplomatike të ShBA-së në Zvicër, në Gjermani dhe në

Shqipëri, në mesin e të cilëve edhe shefi i Misionit diplomatik të ShBA-së në Gjenevë.

"Epoka e re": Për cilat tema u diskutua dhe për çfarë ishin më tepër të interesuar të dinin?

Bardhyl Mahmuti: Hipotezat e përfaqësuesit të shtetit shqiptar, që ishte në takimin kur u njoftova për misionin që na ishte ngarkuar mua dhe Ramadan Avdiut, dolën të sakta. Pyetjet për pikëpamjet ideologjike dhe religjioze të UÇK-së si dhe për raportin ndërmjet LPK-së dhe UÇK-së ishin temat e para që u shtruan për sqarim.

Fatmirësisht, një ditë më parë, më 15 qershor 1998, Radio Televizioni i Prishtinës, që transmetohej nga Tirana, emtoi deklaratën e parë të z. Jakup Krasniqi në cilësinë e zëdhënësit të UÇK-së. Në këtë

deklaratë ai sqaroi se LPK-ja ishte forca politike që kishte merita të pakontestueshme në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe, megjithatë, nuk ka kundërshtuar që UÇK-ja të mbetej jashtë çdo ombrelle partiake.

Për opinionin publik shqiptar në Kosovë dhe Maqedoni Jakup Krasniqi ishte një atdhetar i shquar që kishte kaluar mbi 10 vjet në burgjet serbe; profesor që gëzonte famën e një pedagogu shembullor dhe intelektual që kishte mbështetur të pakontestueshme gjithandej Kosovës. Në përpjekjet për të organizuar një jetë politike dhe institucionale paralele me pushtetin e okupatorëve serbë, në zgjedhjet e organizuara në vitin 1992 dhe në vitin 1998 ishte zgjedhur deputet i LDK-së për Kuvendin e Kosovës. Emërtimi i një kuadri të LDK-së për zëdhënës të UÇK-së demantonte të gjitha zërat e orkestruar nga Beogradi që përpiqeshin ta prezantonin LPK-në si “e majtë ekstreme e tipit stalinist të Enver Hoxhës, që synon të vijë në pushtet nëpërmjet luftës së armatosur”. Jaku Krasniqi nuk kishte qenë asnjëherë anëtar i LPK-së dhe deklarata e tij se UÇK-ja njeh për ideologji vetëm shqiptarizmin, ishte një argument shumë i fuqishëm në duart tona në këtë takim të rëndësishëm.

“Epoka e re”: A ishte rastësi që një ditë para takimit u bë publike se zëdhënësi i UÇK-së ishte Jakup Krasniqi, apo një gjë e tillë është bërë në funksion të përforcimit të imazhit se lufta çlirimtare ishte jashtë ombrellave partiake dhe ideologjike?

Bardhyl Mahmuti: Duke pasur parasysh vështirësitë e komunikimit në atë kohë dhe kërkesën amerikane që takimi të mbetej konfidencial, mendoj se ka qenë rastësi, sepse ndodh shpesh që rastësia i rregullon gjërat edhe më mirë se projektet e paramenduara në detaje. Sidoqoftë për këtë çështje Xhavit Haliti mund ta dijë më mirë nëse dikush në Kosovë ka qenë në dijeni të një takimi të tillë.

“Epoka e re”: Në çfarë kuptimi emërimi i Jakup Krasniqit për zëdhënës të UÇK-së ishte argument i fuqishëm në duart tuaja?

Bardhyl Mahmuti: Për arsye se ishte një dëshmi që nuk mund të kontestohet se vullneti i LPK-së ishte bashkimi i të gjithë shqiptarëve për çlirimin e vendit, pa marrë parasysh dallimet klasore, ideologjike,

partiake, religjioze ose krahinore. Pikërisht për shkak të forcës së këtij argumenti, çështja e cilësimit të LPK-së si “organizatë ekstremiste” u mbyll shumë shpejt si temë diskutimi. Mirëpo gjatë zhveshjes së paradoksit që karakterizonte propagandën serbe që synonte të krijonte opinion në vendet demokratike perëndimore se gjoja UÇK-ja ishte organizatë “marksiste-leniniste-staliniste-enveriste” dhe “fondamentaliste islamike”, delegacioni amerikan kërkoi sqarime të hollësishme lidhur me disa shtylla të kësaj propagande. Një vëmendje e veçantë iu kushtua ndikimit të religjionit në radhët e UÇK-së.

“Epoka e re”: Ka kaluar shumë kohë nga ajo periudhë dhe gjeneratat e reja nuk e dinë cilat ishin sajaset e propagandës serbe për gjoja ndikimin e ekstremizmit fetar në luftën çlirimtare të Kosovës. Çfarë mund të na thoni rreth këtyre sajsave?

Bardhyl Mahmuti: Në kohën e shpërthimit të luftës së armatosur dhe të shpartallimit të Federatës Jugosllave, “terrorizmi me motive fetare” ishte cilësimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar. Për këtë arsye, në rrafshin ndërkombëtar, stigmatizimi i UÇK-së si “organizatë terroriste me pikëpamje fundamentaliste islamike” përbënte një nga shtyllat kryesore të orientimit propagandues të Shtabi Strategjik të pushtetit të Milloshëviqit. Në funksion të kësaj strategjie, ata shpërndanë raporte të shumta dezinformuese lidhur me orientimin “ideologjik dhe religjioz” të UÇK-së. Në shtator të vitit 1998, Sigurimi Shtetëror i Serbisë bëri përmbledhjen e këtyre materialeve dhe e publikoi në botime të veçanta në gjuhën angleze dhe atë frënge, me titull “Libri i bardhë: Terrorizmi i separatistëve shqiptarë në Kosovë dhe në Dukagjin”. Këtë material propagandistik Ministria e Punëve të Jashtme e asaj që kishte mbetur nga shpërbërja e ish-Federatës së Jugosllavisë, ua shpërndau falas institucioneve me rëndësi në marrëdhëniet ndërkombëtare, institucioneve shtetërore të shteteve anëtare të OKB-së, medieve ndërkombëtare, bibliotekave universitare dhe personaliteteve me peshë në fusha të ndryshme intelektuale

“Epoka e re”: Çfarë përmbante konkretisht ky “libër i bardhë” në përpjekjet e Serbisë për ta ndërlikuar UÇK-në me

pikëpamje fundamentaliste islamike?

Bardhyl Mahmuti: Për ta mbështetur tezën për gjoja lidhjet e UÇK-së me ideologjinë e ekstremizmit fetar islam, Shërbimi Sekret i Serbisë sajoi “prova dhe fakte” se kinse “në përpunime me vendimet e Konferencës së 18-të Islamike, të mbajtur në Pakistan në vitin 1998, separatizmi shqiptar në Kosovë ishte cilësuar si ‘xhihad’ dhe të gjitha vendet myslimane ishin ftuar për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane! (...) Kësaj thirrjeje i ishin përgjigjur një numër islamikësh fanatikë nga Afganistani, Algjeria, Egjipti, Çeçenia, Irani dhe nga vende të tjera, të cilët ishin përfshirë në shtabet e njëjste komanduese të UÇK-së në Kosovë, si instruktorë për stërvitje speciale ushtarake të disa formacioneve të UÇK-së”. Për të qenë sa më “bindës”, përpiluesit e këtij libri pohonin se gjoja “më tepër se 1000 mercenarë të huaj nga Shqipëria, Arabia Saudite, nga Jemeni, nga Afganistani, nga Bosnja-Hercegovina dhe nga

Kroacia ishin të angazhuar në radhët e UÇK-së...”.

“Epoka e re”: A kishte diçka të vërtetë në pretendimet serbe se në “Konferencën e 18-të Islamike ishte kërkuar mobilizimi për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane në Kosovë”?

Bardhyl Mahmuti: Ishin gënjeshtër të kulluara! Konferenca e 18-të Islamike nuk ishte mbajtur në Pakistan, siç pretendohet në këtë “Libër të bardhë”, por në Arabinë Saudite dhe me datat 13-16 mars 1989! Pra, gati dhjetë vjet përpara se të fillonte lufta e armatosur në Kosovë! Është e qartë se lufta e Kosovës nuk ka mundur të përmendet dhjetë vjet përpara se të fillonte. Madje në këtë konferencë Kosova nuk është përmendur fare!

Sa i përket Pakistanit, në këtë shtet është mbajtur Konferenca e 21-të Islamike nga 25-29 prilli i vitit 1993. Pra, edhe Konferenca Islamike në Pakistan ishte mbajtur para shpërthimit të luftës në Kosovë

dhe, rrjedhimisht, as në këtë konferencë nuk kishte mundësi të kualifikohej si “xhihad” një luftë që ende nuk kishte filluar. Gjatë Konferencës Islamike të mbajtur në Pakistan në vitin 1993, në kuadër të rezolutës 7/21-P, kushtuar situatës në Bosnjë-Hercegovinë, në pikën 28 të saj përmendet edhe Kosova. Përmes kësaj rezolute “anëtarët e Konferencës Islamike kërkonin nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, që të ndërmeret hapat e nevojshëm për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes, tani më të tendosur, në Kosovë, në Vojvodinë, në Sanxhak dhe në Republikën e Maqedonisë”. Siç shihet qartazi, qëndrimet e shprehura në këtë rezolutë nuk dallonin nga rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Përkundrazi, janë më pak të ashpra se qëndrimet e shprehura në rezolutat e asaj kohe të Këshillit të Sigurimit. Ndërsa në vitin 1998, në kohën kur zhvillohej lufta në Kosovë, Konferenca Islamike mbajti mbledhjen e radhës në Katar. Gjatë sesionit të 25-të të kësaj

DEKLARATË E ZËDHËNËSIT TË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS, JAKUP KRASNIQI, DHËNË TVP-SË, MË 15 QERSHOR 1998

Ushtria Çlirimtare e Kosovës njeh për ideologji vetëm shqiptarizmin

- Lëvizja Popullore e Kosovës është ajo forcë politike që ka meritat e pakonstituara në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
- Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është i mendimit se në këtë fazë të luftës pluralizmi politik është luks.
- Ftojme popullin shqiptar që të qëndrojë në trojet e veta, së bashku me luftëtarët e lirisë, së bashku me pjestarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në mbrojtje të atdheut, të lirisë, të nderit, të dinjitetit kombëtar.

Ushtria Çlirimtare e Kosovës është një lindje e natyrshme, e domosdoshme për ta mbrojtur nderin, dinjitetin kombëtar, për ta mbrojtur popullin e robëruar, atdheun e copëtuar. Pra, Ushtria Çlirimtare përbënë tërësinë e forcave të armatosura të Kosovës që lufton për çlirim e bashkim kombëtar. Ushtria Çlirimtare e Kosovës njeh për ideologji vetëm shqiptarizmin. Lëvizja Popullore e Kosovës është ajo forcë politike që ka meritat e pakonstituara në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është bazamenti fillestar, këmbëngulës dhe i qëndrueshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe, përkundër kësaj, nuk ka kundërshtuar që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të jetë jashtë çdo ombrelle partiake. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të

Çlirimtare të Kosovës, e cila diu dhe munda brenda një kohe të shkurtër të krijojë një territor të gjerë të lirë, do të dijë të mbrojë dhe të krijojë hapësira të reja të lira deri në çlirim të plotë. Do të dëshirojë në këtë rast, të gjithë familjeve të dëshmoreve, në emrin tim dhe në emrin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që t’iu shprehim ngushillimet tona të singerta e posaçërisht iu shprehim ngushëllime familjeve të atyre dëshmoreve që ranë në ditët e para të luftës e që s’patëm mundësi, për shkaqet që dihen, t’iu bëjmë nderimet e merituar.



konferencë u miratua Rezoluta 19/25-P, që kishte të bënte me situatën në Kosovë. Kjo rezolutë nuk përmbante asnjë cilësim të luftës së Kosovës si “xhihad” apo “thirrje drejtuar vendeve myslimane për çlirimin e territoreve të pushtuara myslimane”, siç gënjente propaganda serbe. Propaganda për lidhjet e UÇK-së me ideologjinë e ekstremizmit fetar islam dhe “instructorë të fundamentalizmit islamikë, që stërvitin ushtarët e UÇK-së”, ishin gënjeshtër që synonin t'i manipulonin njerëzit që frikësoheshin nga rritja e rrezikut nga fundamentalizmi islamik dhe në këtë mënyrë të pamundësohej mbështetja e luftës çlirimtare të Kosovës në rrafshin mediatic dhe politik.

“Epoka e re”: Sa u besuan argumenteve tuaja diplomatët amerikanë?

Bardhyl Mahmuti: Sa iu përket rezultateve të këtij takimi do të flas më poshtë. Tani për tani po ju përmend faktin se në një numër të konsiderueshëm takimesh diplomatike dhe në konferenca shtypi me gazetarë të huaj, na është dashur ta sqarojmë thelbin e propagandës që ndërlikonte ekstremizmin fetar me luftën çlirimtare të Kosovës. Po ju përmend një rast që pasqyron mënyrën e përgjigjeve tona rreth kësaj çështjeje.

Disa muaj pas takimit të parë me diplomatët amerikanë, së bashku me Jashar Salihun, Ramadan Avdiun dhe Agush Bujën mbajtëm një konferencë me gazetarë të akredituar në selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë. Gazetari i Agjencisë Telegrafike të Rusisë, ITAR-TASS (siç quhej në atë kohë) u përpoq ta zhvendoste vëmendjen e gazetarëve të tjerë nga dhuna serbe duke shtruar pyetjen se “sa ushtarë fundamentalistë islamikë luftonin në radhët e UÇK-së”. Kësaj pyetjeje grackë iu përgjigja ashtu siç e meritonte: “Ju keni shtruar një pyetje shumë interesante, që lidhet me implikimin politik të religjionit në luftërat që u zhvilluan në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Ju sigurisht e dini, por po sjell disa të dhëna që, eventualisht, mund t'i hyjnë në punë ndonjë gazetari të painformuar për këtë çështje. Po rikujtoj se para disa vitesh, me bekimin e Kishës Ortodokse serbe, është bërë luftë kundër katolikëve në Slloveni. Pas luftës në Slloveni, me bekimin e Kishës Ortodokse serbe, është bërë luftë kundër katolikëve në Kroaci. Lufta vijon në Bosnjë dhe Hercegovinë. Me bekimin



e Kishës Ortodokse serbe është bërë luftë kundër myslimanëve dhe katolikëve në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe tani, në fund, me bekimin e Kishës Ortodokse serbe është duke u bërë luftë kundër myslimanëve dhe katolikëve shqiptarë në Kosovë. Fundamentalizmi ortodoks i Serbisë është jashtëzakonisht i përfshirë në luftën e Kosovës dhe ka arritur të mobilizojë fundamentalistë ortodoksë nga disa shtete të Lindjes, ku shumica e popullsisë janë të religjionit të krishterë ortodoks. Kam kënaqësinë t'ju njoftoj, se gjatë ofensivës së fundit të Forcave të Armatosura të

Serbisë në Kosovë janë vrarë shumë fundamentalistë që kishin ardhur nga Rusia, Rumunia dhe vende të tjera (...).

Gazetarët e tjerë më vërshuan me pyetje se ku ishin vrarë, sa ishin vrarë dhe nga cilat shtete kishte më shumë fundamentalistë ortodoksë që kishin ardhur të luftonin në Kosovë. Gazetari rus e braktisi konferencën...

Me një fjalë, përveç zhveshjes së mashtrimeve të shpërndara nga propaganda serbe, ne përpiqeshim ta tërheqim vëmendjen në gjeneratorin e vërtetë të problemeve: strukturat shtetërore të Serbisë.

“Epoka e re”: Cila ishte përshtypja juaj rreth ndikimit të propagandës serbe? A vërejtët nëse te ndonjëri nga tetë diplomatët amerikanë kishte ndikime të kësaj propagande.

Bardhyl Mahmuti: Fakti se tema të tilla u shtruan si prioritet për sqarim nuk do të thotë se ata i kanë marrë kallëp sajaset serbe. Mirëpo nga qëndrimi i tyre dilte qartë se ishin të interesuar ta shmangnin mundësinë që në Kosovë të ndodhte ngjashëm si në Bosnjë, ku rryma të ndryshme religjioze nga katër anët e botës u përfshinë në konflikt. Ne u garantuam se një gjë e tillë nuk do të ndodhte me UÇK-në, por theksuam se

ndihma e shteteve demokratike ishte mënyra më e mirë për ta parandaluar ndikimin politik të grupeve fetare.

“Epoka e re”: Përveç aspekteve ideologjike dhe religjioze të UÇK-së, cila temë kishte zgjuar interesimin e tyre?

Bardhyl Mahmuti: Sqarimet rreth çështjes së propagandës serbe që prezantonte si civilë pjesëtarët e aparateve represive të vrarë në tesha civile morën një kohë të konsiderueshme. Këtë çështje e kemi trajtuar gjerësisht në pjesët paraprake të intervistës.

(Muhamet MAVRAJ / Vijon)

Krasniqi në Prizren: Modeli ynë i qeverisjes së mirë lokale, modeli që ia ofrojmë Kosovës në nivelin qendror

PRIZREN, 6 DHJETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka vizituar qytetin e Prizrenit, për t'i parë nga afër punët përmes të cilave kryetari Shaqir Totaj me ekipin e tij janë duke transformuar kryeqytetin historik e kulturor.

Krasniqi, i shoqëruar nga Totaj, përcolli nga afër punimet në transitin e ri, një projekt infrastrukturor që kishte qenë i bllokuar për më shumë se 15 vjet, ndërsa sot është i përfunduar dhe po shfrytëzohet nga qytetarët.

Gjatë kësaj vizite kryetari Krasniqi mori pjesë edhe në nisjen e punimeve për revitalizimin e rrugës "Shuaib Spahiu", e cila do të lidhet me Shatërvanin, për t'i dhënë një tjetër pamje të bukur Prizrenit. Ai tha se ky model i qeverisjes së mirë, të cilën kryetari Totaj e ka

instaluar në Prizren, është modeli që PDK-ja ia ofron Kosovës. "Prizreni, me qeverisjen e kryetarit Totaj, është rikthyer në një model të qeverisjes së mirë. Ky është modeli të cilin ne ia ofrojmë qytetarit të Kosovës edhe në nivelin qendror. Ky është modeli që i duhet Kosovës, i cili, fatkeqësisht, sot po i mungon shumë vendit tonë. Ky është modeli që kryen punë, i mban premtimet dhe është në shërbim të qytetarëve. Këtë model ne jo vetëm që do ta ofrojmë dhe do ta zbatojmë në të ardhmen", ka thënë Krasniqi. Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se ekipi të cilin ai e udhëheq është i përkushtuar që të bëjë punë të mira, të transformojë qytetin dhe ta përmirësojë cilësinë e jetesës së qytetarëve të Prizrenit.



Kërkohet drejtësi për Liridonën e siguri për gratë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Qindra qytetarë morën pjesë në një marsh protestues të martën në Prishtinë pas vrasjes tragjike të Liridona Murselit më 29 nëntor. Ata kërkuan drejtësi për vrasjen e Liridonës dhe dënime meritorë për vrasësit e saj, ndërkohë që thanë se Kosova është shndërruar në vend të pasigurt për gratë. Marshi u organizua me moton "Nuk ka paqe pa sigurinë e grave".

Leonard Ademaj, vëllai i Liridonës, ka thënë se nuk kanë fjalë të shprehin mirënjohje për të gjitha organizimet për ta nderuar Liridonën dhe për të kërkuar drejtësi për të gjitha gratë dhe vajzat e vrara. "Ditët po na bëhen edhe më të vështira dhe mezi po kalojnë e dhimbja po rritet, por organizimet në shumë qytete në Kosovë dhe në Shqipëri po na japin forcë që të mos

dorëzohemi. Sonte bashkë me nënën po i përcjellim lajmet dhe marshin në Prishtinë dhe ndonëse shumë e pikëlluar, nëna vazhdimisht po thotë faleminderit prej tyre që po e bëjnë këtë për Donën time. Kampanja jonë për drejtësi fillon tash, bashkë me juve aktiviste,



organizata joqeveritare dhe me mbështetjen e medieve. Ne duam drejtësi të shpejtë dhe profesionale, pa vonesa dhe pa gabime. Kriminelët duhet të kalben në burg. Asnjë grua tjetër nuk duhet të vritet. Ne besojmë në institucionet e shtetit dhe presim që të ndajnë drejtësi", ka shkruar Leonard Ademaj në "Facebook".



Tahiri takon Viola von Cramonin: Anëtarësimi në NATO dhe BE i Kosovës duhet të jetë fokusi kryesor

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka takuar raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon. Gjatë takimit ata kanë diskutuar për

procesin e integritimit në BE, reformat në administratën publike dhe rrugën përpara. Në takim Tahiri ka theksuar se anëtarësimi në NATO dhe BE i Republikës së Kosovës duhet të jetë fokusi kryesor

për të gjithë aktorët ndërkombëtarë. "E falënderova Violën për rolin e saj të jashtëzakonshëm në këtë proces dhe në mbështetjen të Kosovës", ka thënë Tahiri.

Hapet Java e të Drejtave të Njeriut

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë të mërkurën në konferencën hapëse të Javës së të Drejtave të Njeriut, të organizuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YIHR).

Kryeministri Kurti shprehu kënaqësinë që ishte për të tretin vit radhazi në konferencën hapëse të Javës së të Drejtave të Njeriut, që këtë vit shënon edicionin e dhjetë, ndërkaq i përgëzoi për përkushtimin e Nismës së të

Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë përgjatë kësaj dekade. Në fjalën e tij para të pranishmëve, kryeministri tha se beson se të drejtat e njeriut janë edhe thelbi edhe themeli i qytetërimit. "Gjithçka bëhet

aq e vështirë sa që e pamundur nëse nuk besojmë në të drejtat e njeriut dhe gjithçka bëhet aq e lehtë pothuajse, menjëherë e realizueshme atëherë kur besojmë në të drejtat e njeriut", ka shtuar Kurti.



“Oferta e kredisë shtrëngohet, ndërsa bankat në rajon synojnë zgjerimin mes shqetësimeve të rentabilitetit”

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Anketa e huadhënies bankare të BEI-t (Banka Evropiane e Investimeve) për Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore për gjysmën e dytë të vitit 2023 thekson një shtrëngim të vazhdueshëm të ofertës së kredisë në rajon. Ndërsa hendeku ofertë-kërkesë është ngushtuar në krahasim me periudhat e mëparshme, oferta e kredisë mbetet e kufizuar në Serbi, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë. Kërkesa për kredi nga klientët e bankave ka mbetur e qëndrueshme dhe pritet të përmirësohet lehtë. Investimet fikse dhe të pakicës,

veçanërisht tregu i banesave, kanë kontribuar negativisht, por pritet të rifillojnë në periudhën pasuese. Ndryshe nga parashikimet negative të mëparshme, cilësia e kredive është përmirësuar gjatë gjashtë muajve të fundit. Megjithatë, duke pasur parasysh perspektivën më të dobët ekonomike dhe normat më të larta të interesit, bankat presin sërish një rritje të kredive me probleme gjatë gjashtë muajve të ardhshëm. Nën kryetari i BEI-t, Kyriacos Kakouris, ka theksuar se rezultatet e anketës tregojnë se shtrëngimi i ofertës së kredisë që

filloi në vitin 2022 për shkak të luftës në Ukrainë, inflacionit, normave më të larta dhe ngadalësimeve ekonomike, është ende në proces. “Të gjitha segmentet e biznesit janë prekur nga kushtet e shtrënguara të ofertës, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këtu vjen roli i BEI Globale, e cila do të vazhdojë të ofrojë financime të favorshme përmes ndërmjetësve tanë financiarë për bizneset e vogla në rajon për t'i ndihmuar këto të adresojnë kufizimet e tyre financiare, të dekarbonizohen, të shpenzojnë dhe të krijojnë vende të reja pune”, ka pohuar Kakouris.



Paraqitet Masa 1.2 për subvencionimin e blerjes së lëndës djegëse për dimër



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Nën organizimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, të mërkurën është mbajtur takimi për paraqitjen e masës 1.2 për zvogëlimin e ndikimit të krizës energjetike te familjet në asistencë sociale, përkatësisht subvencionimin e blerjes së lëndës djegëse për dimër për familjet në asistencë sociale. Me Masën 1.2, e cila në qendër ka

grupet e cenushme të shoqërisë, ata të cilët kanë më së shumti nevojë për dorën e shtetit, do të mundësohet subvencionimi i blerjes së lëndës djegëse për ngrohje për familjet në asistencë sociale, me qëllim tejkalimin sa më të lehtë të dimrit për këto familje. Për këtë masë janë ndarë pesë milionë euro. Nga ajo pritet të përfitojnë rreth 21 mijë familje e

rreth 81 mijë qytetarë. Në fjalën hyrëse të tij, kryeministri Albin Kurti u shpreh se fundi i vitit simbolizon një periudhë ku të gjithë shënojnë arritje e reflektojnë mbi sfidat me të cilat jemi përballur. Ai shtoi se është i lumtur që në fushën e mirëqenies shoqërore shumë sfida i kanë tejkaluar dhe ato i kanë shndërruar në arritje. Duke e konsideruar si një shtyllë

thelbësore në kuadër të programit qeverisës, kryeministri Kurti ka potencuar se për faktin që ishin të rrethuar nga një ambient i vështirë dhe i rëndë, kjo e ka përforcuar edhe më shumë përkushtimin dhe mbështetjen e qeverisë drejt kujdesit për qytetarët. Ai tha se pas këtyre gati tre viteve qytetarët tanë tani e dinë që përballë vështirësive të kohës ata nuk do të jenë asnjëherë vetëm

ose të vetmuar, sepse “jemi dhe mbetemi qeveri që udhëheq dhe që mbështet, që prin dhe që nuk lë askënd prapa”.

Ndërkaq, ministri i Financave Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, foli rreth mënyrës së subvencionimit të kësaj mase i cili realizohet në llogaritë bankare të familjeve përfituese.

Ai sqaroi edhe mënyrën e përfitimit të kësaj mase. “Si familje përfitimi është 120 euro, që është ekuivalent me 2 metër kub, ndërkaq për çdo anëtar të familjes është 30 euro shtesë, që nënkupton që për një familje katëranëtarëshe do të jetë 120 euro për familjen, 120 euro të tjera, pra nga 30 euro për secilin anëtar, që i bie që një familje katëranëtarëshe në total do t'i pranojë 240 euro si mbështetje në mënyrë që ta tejkalojë sa më lehtë sezonin e dimrit”, tha ai.

Ministri Murati potencoi se për të përfitur nga kjo masë nuk ka nevojë për aplikim, meqenëse Qendrat për Punë Sociale tashmë kanë familjet të cilat pranojnë mbështetje sociale. Kjo masë është e mbështetur nga Bashkimi Evropian në kuadër të Pakos Energjetike Emergjente të Bashkimit Evropian.

Ruqi: Mbi 26 mijë qytetarë i janë shtuar listës së qytetarëve të varfër në qeverisjen Kurti

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Zyrtari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Berat Ruqi, ka reaguar ndaj vendimit të qeverisë Kurti për të ndarë 5 milionë euro në përkrahje të qytetarëve në nevojë për blerjen e druve për ngrohje gjatë dimrit. Ai ka shkruar në “Facebook” se mbi 26 mijë qytetarë i janë shtuar listës

së qytetarëve të varfër në qeverisjen Kurti: “Kryemashtruesi nën presion nga skandalet, me dështime në çdo fushë që i prek qytetarët e vendit dhe nën sanksione, i kthehet edhe njëherë kartës së popullizmit. E ka shndërruar qeverisjen në nivelin e një organizatë që shpërndan ndihma. Duhet të ia rikujtojmë prapë, që

me ndihma nuk ka zhvillim e as punësim. Mbi 26,000, është numri i qytetarëve që i janë shtuar listës të të varfërve në dy vite të qeverisjes të Lëvizjes Vetëvendosje. Qytetarët nuk kanë nevojë për lëmoshë. Kanë nevojë për vende pune, si dhe jetë të përbalueshme dhe të dinjitetshme.



RECENSION LIDHUR ME BOTIMIN E DYTË TË LIBRIT TË MR. SCI. HAMËZ LLADROVCIT

“Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe (1856-2022)”



Prof. dr. Muhamet MALA

Pasi që botimi i parë i librit: “Çështja shqiptare përballë diplomacisë dhe gjeopolitikës rusomadhe 1856-2022” u mirëprit nga opinioni shkencor dhe rrethi i gjerë i lexuesve, autori, ma. Hamëz Lladrovci, iu përvesh publikimit të dytë të librit tanimë të plotësuar me përmbajtje të re dokumentare e analitike.

Botimi i këtij libri të plotësuar është si një dëshmi e qartë se shkencën historike avancim gjithnjë, duke sjellë vlerësimin kritik, si dhe interpretimin e burimeve dhe të dokumenteve të reja në favor të prezantimit sa më real të së kaluarës historike.

Edhe kësaj radhe, libri përmban strukturë bazë, që fokusohet në çështjen shqiptare, përballë diplomacisë më jo miqësore me shqiptarët, pra diplomacisë ruse, e cila duke pretenduar ndikimin gjeopolitik në Ballkan u bë përkrahësja e flakët e vendeve ortodokse, në dëm të çështjes shqiptare. Është pothuajse e pabesueshme, që ky qëndrim i politikës ruse mbeti i njëjtë dhe armiqësor, me disa përrastime të vogla gjatë periudhës komuniste, madje, edhe atëherë mbështjell me dredhinë e internacionalizmit proletar. Rrjedhimisht, në këtë libër e kaluara në mënyrë paradoksale përpunet, pothuajse, në tërësi me aktualitetin. Rastet e tilla dëshmojnë faktin se disa ngjarje dhe disa aktorë të historisë, përkundër ndryshimeve kohore mbesin të njëjtë në veprime dhe në qëndrime, duke ndjekur skemat diplomatike të paracaktuara shumë kohë më parë. Kjo përmbledhje e plotësuar e botimit të dytë, përshkruan, hulumton dhe publikon një qëndrim të tillë, të përdryshuar në kohë dhe në hapësirë të politikës rusomadhe ndaj shqiptarëve, e cila me disa ndryshime të vogla mbeti antishqiptare, që nga koha kur u krijua dhe vazhdon të jetë e tillë deri më sot.

Autori i librit, H. Lladrovci, duke e qenë në dijeni të këtyre zhvillimeve historiko – diplomatike, me një guxim profesional, por edhe me sugjerimet e recensentit të parë, prof. dr. E. Zenelaj e plotëson një zbrazëti të mbetur studimore. Përmes këtij libri na ofrohet një tablo e raporteve dhe e qëndrimit të diplomacisë ruse ndaj shqiptarëve, që nga Konferenca (Traktati) e Parisit e vitit 1856, kur Fuqitë Evropiane ndërhyjnë ushtarakisht kundër Rusisë së atëhershme, duke mbështetur Perandorinë e dobësuar osmane, si dhe duke e afruar atë në të ashtuquajturin “Koncertin e Evropës” e deri më 2016, respektivisht, deri në ditët e

sotme, kur Rusia vazhdon ende të veprojë nën hijen e panslavizmit rus, duke mbështetur planet shoviniste serbe ndaj çështjes shqiptare në përgjithësi, e ndaj Kosovës në veçanti, respektivisht, në përkrahjen e strukturave kriminale serbe në veri të Kosovës. Ashtu si në të kaluarën, edhe sot çështja shqiptare në libër shikohet nga prizmi më i gjerë i gjeopolitikës botërore, që sot i referohet luftës së Rusisë në Ukrainë dhe tendencave ruse, që me destabilizimin e Kosovës përmes serbëve ta lehtësojë barrën e luftës në Ukrainë, duke përqendruar vëmendjen te një rajon tjetër.

Duke lexuar këtë publikim, kuptojmë se në historinë diplomatike të Ballkanit, zakonisht, aleancat politike funksionuan, duke u mbështetur në interesat e përbashkëta politiko-etnike sllave, në afërsi religjioze e ortodokse, apo në afërsi etnike dhe gjuhësore. Në të gjitha këto kombinime, shqiptarët u lanë jashtë skemave diplomatike të fqinjëve hileqarë ballkanikë, duke ia ndarë atyre rolin e viktimës dhe jo të aleatit, siç do të duhej në realitet.

Duke studiuar këto raporte të komplikuar gjeopolitike të Rusisë ndaj çështjes shqiptare, nga ky botim kuptojmë se qëndrimi armiqësor i Rusisë ndaj çështjes shqiptare ishte i ndikuar nga interesi gjeopolitik dhe diplomatik për të dalë në “Dete të nxehta”, e që për këtë gjë domosdoshmërisht duheshin pushtuar tokat shqiptare. Në këtë rrugëtim antishqiptar, pa dyshim, qëndrimi rus ishte pro sllavëve ballkanikë apo grekëve ortodoksë. Për t’i sqaruar këto zhvillime dramatike, të natyrës gjeopolitike dhe diplomatike, autori Lladrovci në publikimin e tij ka kombinuar me sukses disa metoda hulumtimi dhe burime të proveniencave nga më të ndryshmet, si ato evropiane, ashtu edhe ato kombëtare. Vlerën shkencore, publikimit, pa dyshim, se ia shton edhe tryeza e gjerë e

materialit arkivorë, respektivisht, dokumenteve të sjella nga arkivat e Vjenës, të Budapestit, të Parisit, të Tiranës dhe të Brukselit. E gjithë kjo problematikë në librin e z. Lladrovci është e përmbledhur në pesë kapituj, që në vete ndjekin rendin kronologjik. Kapitulli i parë, në një formë informative i dedikohet historisë së shkurtër të popullit rus apo siç shprehet vetë autori paraqet një “ekskurs” të shkurtër të historisë ruse, duke sjellë fakte interesante nga e kaluara e largët dhe e tanishme e popullit rus. Kapitulli i dytë i referohet, kryesisht, gjysmës së dytë të shek. XIX dhe më vete ka, kryesisht, përmbajtje të natyrës diplomatike, ku analizohet lindja dhe përhapja e idesë pansllaviste, respektivisht, ideja e panslavizmit ruso - sllav. Mbështetur në dokumente më të reja burimore, autori trajton prapaskanat e diplomacisë austro-hungareze dhe ruse, në raport me çështjen shqiptare, duke përmendur marrëveshjen e fshehte të Reichstadt (1876), ku për herë të parë shtrohet në rrafshin diplomatik çështja shqiptare. Trajtimi i kësaj teme në punim, konsiston në idenë se në historiografinë kombëtare, kjo konferencë është trajtuar jo në mënyrë meritore, andaj autori e rikthen edhe njëherë në vendin e duhur, duke ofruar të dhëna interesante, lidhur me vendin e shqiptarëve në gjeopolitikën evropiane të kohës.

Kapitulli i radhës, në kuptimin kohor i dedikohet fillimit të shek. XX dhe fillon me aleancat ballkanike, që i paraprinë luftërave ballkanike dhe shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, e cila nuk u prit aspak mirë nga qarqet diplomatike ruse, sepse ishte në kundërshtim me aspiratat ekspansioniste të politikës rusomadhe. Kapitulli, gjithashtu, trajton edhe ndikimin e carizmit rus në Ballkan, në kohën e Luftës së Parë Botërore, si dhe rolin e presidentit amerikan, Wilson, që

kishte filluar të paraqitej në skenën diplomatike të Evropës, e që sadopak do të balancoje drejtpeshimin e prishur politik në Ballkan dhe në Evropë dhe do të imponohej, si aktor i ri, në skenën diplomatike të botës.


Është me interes të veçantë, veçmas nga sensi kritik i historiografisë, trajtimi, që autori ia bënë qasjes së politikës së Rusisë socialiste, ndaj vendeve ballkanike, si dhe raporteve të qeverisë demokratike të Fan Nolit, lidhur me këtë çështje. Pa dyshim, se lidhur me këto zhvillime, historiografia moniste shqiptare kishte shkruar nga këndvështrimi ideologjik, andaj autori mundohet që të jetë sa më real në trajtimin e këtyre ngjarjeve, jashtë klisheve ideologjike e politike të së kaluarës. Gjithsesi, duke ndjekur në tërësi rendin kronologjik, në kapitullin në vazhdim, libri paraqet kohën e qeverisjes së komunistëve në Shqipëri dhe raporteve të tyre me Bashkimin Sovjetik. Kjo përmbajtje, pa dyshim, se përmban më vete disa njoftime me vlera shkencore, ku trajtohen problemet e natyrës politike, ushtarake, ekonomike e kulturore, që Shqipëria e Enver Hoxhës pati me Bashkimin Sovjetik, nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore, e deri me 1961, kur edhe erdhi deri te ndërprerja përfundimtare e këtyre raporteve, si dhe dalja e Shqipërisë socialiste nga Pakti i Varshavës - më 1968.

Kapitulli i fundit në libër i dedikohet, kryesisht, çështjes së Kosovës, shikuar nga prizmi i politikës ruse dhe qëndrimit e saj ndaj ndërhyrjes së NATO-s dhe pavarësisë së Kosovës. Pa dyshim, se rëndësi më vete, në këtë kapitull, paraqesin temat, që elaborojnë qëndrimin e Federatës Ruse ndaj pavarësisë së Kosovës dhe anëtarësimit të saj në organizatat ndërkombëtare. Autori duke u mbështetur në qëndrimet aktuale të politikës ruse ndaj Kosovës, me të drejtë te personaliteti i presidentit rus, Vladimir Putin, e

sheh vazhduesin e politikës pansllaviste dhe mbështetësin kryesor të politikës shoviniste të Serbisë. Ky vlerësim i drejtë u vërtetua edhe me rastin e agresionit rus ndaj Ukrainës, që filloi me 24 shkurt 2022 dhe vazhdon edhe sot pa ndonjë perspektivë të qartë të përfundimit. Ndoshta, rasti i pushtimit rus të një pjese të Ukrainës është dëshmia më e fortë se politika ruse e agresionit dhe ekspansionit ushtarak nuk ka pushtar asnjëherë gjatë historisë, por vetëm ka ndërruar taktikën dhe ka vepruar në pajtim me interesat e ngushta, ashtu si vepron sot, duke nxitur Serbinë që ta destabilizojë Kosovën dhe Ballkanin. Njëkohësisht, autori, një politikë të tillë anakroniste të Rusisë dhe të Serbisë ndaj Kosovës me të drejtë e sheh si rrezikim i paqes ndërkombëtare dhe rikthimin e dhunës dhe të luftërave të fundshekullit të kaluar. Me të drejtë, nga libri mund të kuptohet se me gjithë dëshirën e mirë dhe përpjekjet e bëra për të bashkëpunuar me popujt fqinj, për pavarësimin politik dhe çlirim kombëtar, shqiptarët nuk hasen në mirëkuptim apo nuk gjeten aleatë të mirëfilltë të fqinjët e tyre. Për këtë arsye një pjesë të mirë të fajit e bart edhe politika nxitëse dhe ekspansioniste rusomadhe, e cila i frymëzonte dhe i ndihmonte shtetet fqinje sllave të Ballkanit kundër shqiptarëve, njësoj siç vepron edhe sot me rastin e ndihmës që i ofron Serbisë në destruktivitetin e saj, në raport me Kosovën. Shpeshherë politika rusomadhe ndaj shqiptarëve është e maskuar me terminologji fetare e kulturore, e që për qëllim ka pasur dhe vazhdon te ketë: për ta ndihmuar Serbinë, që të shpëputë territore të caktuara nga Republika e Kosovës. Sipas shënimeve të librit e tërë diplomacia ruse ndaj shqiptarëve është ngritur mbi përkrahjen e politikës serbe dhe mitologjisë historike për Kosovën si “djep i Serbisë”, që, pa dyshim, se bien ndesh me realitetin historik dhe burimet relevante.

Është meritë fakti se, në këtë libër, dëshmohet se politika rusomadhe ndaj shqiptarëve nuk ishte e rastit dhe e hartuar në mënyrë individuale. Ajo ishte konsistente në kohë dhe në hapësirë dhe ishte institucionale, ku qëllimi kryesor i saj ishte dhe vazhdon të jetë dominimi politik, ekonomik e ushtarak i shtetit serb në Ballkanin Perëndimor, e rrjedhimisht, edhe i Rusisë.

Mbështetur në atë që u shkrua më lart, mund të koloadojmë se e gjithë lënda e përfshirë në këtë ribotim më tërë përmbajtjen e vet, paraqet një kontribut plotësisht original, pasi që në këtë fushë komplekse kërkimore, autori ka publikuar, por tani edhe ka shtuar burime dhe dokumente të reja arkivore të pabotuara, si dhe i ka bashkangjitur literaturën relevante dhe shtypin e kohës, duke bërë, që libri të paraqet një avancim shkencor dhe publicistik në fushën e diplomacisë dhe të gjeopolitikës.



BOTIMI E DYTË TË LIBRIT TË MR. SCI. HAMËZ LLADROVCIT: “ÇËSHTJA SHQIPTARE PËRBALLË DIPLOMACISË DHE GJEOPOLITIKËS RUSOMADHE (1856-2022)”

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kuka pret përkrahje për kampionët e xhudos në Evropian

PEJË, 6 DHJETOR - Kampionati Evropian i Xhudos "Prishtina 2023" po afron. Kanë mbetur edhe 10 ditë deri te dita kur yje të shumtë të xhudos nga e gjithë bota do të zbarkojnë në Kosovë. E për Evropianin e Xhudos "Prishtina 2023", trajneri i ekipit të Kosovës, Driton Kuka, ka thënë se kjo është hera e parë që kemi një nivel kaq të lartë të një gare në

Kosovë. "Evropiani absolut po vjen në Kosovë! Në kryeqytetin tonë javën tjetër po zbarkojnë elita e xhudos botërore. Kampionati Evropian absolut deri 73 kg për meshkuj dhe deri 57 kg për femra mbahet më 16 dhjetor në Prishtinë! Hera parë të kemi nivel kaq të lartë në shtetin tonë", ka shkruar Kuka në "Facebook", i cili më pas ka bërë me dije edhe emra të

njohur si Azeri Hajdarov (i pari i ranglistës botërore të xhudos) që do të vijë në Kosovë. "I pari i ranglistës botërore Azeri Hajdarov, legjenda e xhudos, Kampion Olimpik Shavdatuashvili, nënkampioni olimpik, italiani Lombardo, do të vijë në Kosovë e për ne garojnë Akil Gjakova dhe Dardan Cena që do të jenë të motivuar si kurrë më parë.

Kategoria e femrave deri 57 kg, përveç dy kampioneve tona olimpike, do të marrin pjesë nga elita botërore edhe shumë medaliste botërore e evropiane!", ka shtuar Kuka. Trajneri i ekipit të xhudos së Kosovës ka thënë se pret përkrahje nga tribunat për kampionët e Kosovës. "Pallati i Rinisë me datë 16 dhjetor do t'i shohë yjet e sportit të xhudos.



Presim përkrahje nga tribunat për kampionët tanë! Foto nga përgatitjet finale për evropianin absolut!", ka shtuar Kuka.

Kualifikohen Drita, Prishtina dhe Ballkani, eliminohen Liria dhe Fushë-Kosova

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Fitoren më të thellë të mërkurën në kuadër të 1/16 të Kupës së Kosovës në futboll e ka shënuar Drita. Klubi gjilanas e ka shkatërruar Dardaniën, pasi e ka mposhtur me rezultat 0-9. Blend Baftiu realizoi golin e parë në ndeshje në minutën e 33-të, ndërsa dy minuta më vonë i njëjti futbollist realizoi për 2-0. Drita realizoi edhe dy gola të tjerë në pjesën e parë me anë të Vitijës dhe Tahirit.

Në pjesën e dytë Drita sërish ishte e fuqishme dhe realizoi edhe pesë gola të tjerë. Rilind Haziraj shënoi dy gola, kurse me nga një gol

kontribuan Maliqi, Isufi dhe Ovouka.

Është kualifikuar edhe fituesja e Kupës së Kosovës në edicionin e kaluar, Prishtina. Në kuadër të rrethit të dytë, kryeqytetasit shënuan fitore në duel me Rahovecin (2-0). Të dy golat për bardhekaltrit i shënoi Jalen Blesa. Të parin e realizoi nga penalltia në minutën e 20, të dytin në minutën e 85-të. Tutje është kualifikuar edhe kampioni në fuqi, Ballkani, që e mposhti Drenicën me rezultat 0-2. Ndërkohë, Liria dhe Fushë-Kosova janë eliminuar nga Kupa qysh në përballjet e para. Fushë-Kosova pësoi humbje në 1/16 e finales nga 2 Korriku, me rezultat 3-1, ndërsa



Liria u mposht nga Rilindja 1974 kohën e rregullt dhe pas pas penalltive, 4-5, pasi ndeshja në vazhdimëve u mbyll 2-2.

REZULTATET

Flamurtari - Dukagjini	0-3
Rahoveci - Prishtina	0-2
Vllaznia P - Trepça '89	2-4
Dardania - Drita	0-9
Vëllaznimi - Ferizaj	2-1
Drenica - Ballkani	0-2
Feronikeli 74 - Istogu	2-0
Liria - Rilindja 1974	2-2
pas penalltive 4-5	
Ramiz Sadiku - Gjlani	1-3
Fushë Kosova - 2 Korriku	1-3
Llapi - Phoenix	4-1
Malisheva - Kika	3-2

Të enjten takohen:
Prishtinë e Re - Behari
Suhareka 23 - Trepça
Ulpiana - Vjosa

Të premten takohen:
Dinamo - Vushtrria



Zyberaj nderohet me dekoratën "Nderi i Komunës së Rahovecit"

RAHOVEC, 6 DHJETOR - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, e ka nderuar me dekoratën "Nderi i Komunës së Rahovecit" atletin Erzen Zyberaj dhe i ka dhënë subvencion në vlerë prej 1000.00 eurosh. Zyberaj më 28 nëntor ka vrapuar 260 kilometra nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtinë deri në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë. "Pata

kënaqësinë të pres në takim atletin e shtigjeve të gjata, Erzen Zyberaj, nga Drenoci, të cilit i ndava dekoratën 'Nderi i Komunës së Rahovecit', për kontributin e madh dhënë afirmimit të sportit të atletikës dhe përfaqësimin e denjë të Republikës së Kosovës në arenën kombëtare e ndërkombëtare. Sportistët si Erzeni janë imazhi

më i mirë i Rahovecit dhe Kosovës, andaj edhe përkrahja nuk do t'i mungojë asnjëherë. Për motivacion të mëtejshëm në sportin e atletikës, Erzenit, i ndava subvencion në vlerë prej 1000.00€. E përgëzoj për arritjet e njëpasnjëshme dhe i dëshiroj mbarësi e suksese në rrugëtimin e tij! Krenar me Erzenin!", ka shkruar Latifi në "Facebook".

Rifati: Marmarinos kishte njohuri zero për ligën dhe lojtarët e Kosovës

Prishtinë, 6 dhjetor - Ish-përzgjedhësi i Kosovës, Christos Marmarinos, në një deklaratë për mediet greke të martën, e ka krahasuar basketbollin në Kosovë me atë të viteve '70. Ai i ka akuzuar ndihmësit e tij për mungesë profesionalizmi dhe ka kritikuar organizimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës.

Të mërkurën Marmarinosit i është kundërpërgjigjur ish-asistenti i tij, Arbnor Rifati. "Fillimisht konstatoj se të gjitha

akuzat e lëshuara nga ana e ish-selektorit janë të pavërteta dhe paranoike. Unë në tetor të vitit 2021 jam zgjedhur ndihmëstrajner i Përfaqësueses së Kosovës. Për dy dritare ishim së bashku me të dhe dy trajnerët Dritëro Sefaja e Bujar Loci", ka thënë Rifati. "Akuzat e tij, se ndihmësit e tij ishin joprofesionale, duke aluduar këtu edhe trajnerët para meje Illmen Bajra, Andin Rashica, janë plotësisht irena të kulluara, pasi

të gjithë ne kemi punuar me zell, bile kemi kryer edhe punën e tij", u shpreh ai.

Rifati e ka akuzuar Marmarinosin se nuk i njihje basketbollistët vendorë. "Kur hartonim listën e gjerë shumicën e lojtarëve nuk i njihje fare, ndërsa informacionet mbi ligën e Kosovës i kishte 0. Kur dihet që gjithë rosteri i përfaqësueses së Kosovës ka qenë i përbërë nga Superliga e Kosovës, në dy grumbullime ka ardhur me vonesë dhe sigurisht

se të gjithë materialet, videoanalizat i kemi përgatitur ne dhe materialet ende i posedojmë secili nga ne", u përgjigj Rifati ndaj akuzave të ish-selektorit.

Tekniku prizrenas, i arrestuar në qershorin e këtij viti nën dyshimet për kurdije të ndeshjeve, foli edhe për rastin e "basketbollistit të patateve", siç i është referuar Marmarinos në intervistën e tij. "Për rastin e patateve ajo nuk qëndron e vërtetë, pasi lojtari në fjalë



asnjëherë s'ka qenë pjesë e përfaqësueses, por vetëm i një klubi basketbollistik", u shpreh Rifati.

FShF-ja përzgjedh kampin bazë të Shqipërisë në Gjermani

Tiranë, 6 dhjetor - Federata Shqiptare e Futbollit ka përzgjedhur kampin bazë ku do të stacionohet Kombëtarja shqiptare gjatë ditëve të qëndrimit në Gjermani për finale të "Euro 2024". Departamenti i

Komunikimit në FShF bën me dije se qendra ku do të qëndrojë skuadra kuqezi përgjatë finaleve të turneut quhet "SportCentrum Kaiserau", një kompleks nga më të mirët në Gjermani për ekipe sportive në afërsi të

Dortmundit. Qendra stërvitore është e specializuar për grumbullime dhe faza përgatitore të skuadrave dhe ka eksperiencë të pasur, pasi aty janë grumbulluar për faza përgatitore apo për turne në

të kaluarën ekipet kombëtare të Gjermanisë, Brazilit, Spanjës, Bregut të Fildishtë apo klube si FC Bayern Munchen, Real Madrid, FC Liverpool, FC Porto, Borussia Dortmund, Schalke 04, Valencia e shumë klube tjera.



Lala: Me Kroacinë dhe me Italinë mund t'i marrim nga 3 pikë

TIRANË, 6 DHJETOR - Altin Lala ishte i ftuar përmes një lidhjeje direkte nga Gjermania me emisionin "Shqipëria Live" në "Top Channel". Ish-mesfushori shqiptar ka komentuar shortin e Shqipërisë për "Euro 2024". Megjithatë gjendemi në grupin më të vështirë të mundshëm, me kundërshtarë si Spanja, Kroacia dhe Italia, Lala nuk e humb besimin te Kombëtarja. Ai është shprehur se ndaj Italisë dhe Kroacisë kuqezinjët mund t'i marrin tri pikët. "Unë shoh shanset tona. Spanjën e shoh shumë të vështirë që t'i marrësh tri pikë. Kurse Italia dhe Kroacia janë të dyja të mundshme. Mund t'i marrësh tri pikë me të dyja. Natyrisht, duhet të ecë çdo gjë mbarë. Duhet të kesh edhe shumë fat. Besoj se djemtë që do të jenë në fushë, por edhe në bankinë, do ta shijojnë këtë gjë", u shpreh ish-futbollisti shqiptar. "Jo vetëm që do ta shijojnë, sepse nuk po shkojnë për turizëm, të japin maksimumin, bashkë me ndihmën e tifozëve. Shumica e lojtarëve tanë që luajnë në



formacion, luajnë në Itali. Kështu që e njohin shumë mirë futbollin Italian. Prandaj thashë që me Italinë dhe Kroacinë

mendoj se do të kemi shanset tona. Të shpresojmë. Ndoshta bëjmë një mrekulli", ka deklaruar Lala.

Lakersat dhe Milwaukee kalojnë në gjysmëfinale të Kupës së NBA

Los Anxhelos, 6 dhjetor - Los Angeles Lakersi mposhti Phoenix Suns-in me rezultat 106-103 për të kaluar në gjysmëfinalen e Kupës së NBA. Ka qenë një ndeshje shumë interesante. Në fund lakersat, falë përvojës, fituan. LeBron Jamesi ka qenë fantastik në këtë duel me 31 pikë, tetë kërcime e 11 asistime, derisa Anthony Davis ishte i jashtëzakonshëm me 27 pikë e 15 kërcime. Me lojë të mirë te vendasit u dallua edhe Austin Reavesi me 20 pikë, ku realizoi një treshe vendimtare 15 sekonda para fundit të ndeshjes. Kevin Duranti me 31 pikë ishte më efikas te skuadra mysafire, por që nuk mjaftuan për fitore.

Mbrëmë u luajt një tjetër ndeshje e çerekfinale të turneut "in-sezon", në të cilën Milwaukee mundi New Yorkun me rezultat 146:122 falë 35



pikëve, 8 kërcimeve dhe 10 asistimeve të Giannis Antetokounmpo. Në gjysmëfinale Los Angeles

Lakersi përballet me New Orleans Pelicansin, ndërsa në lindje Milwaukee Bucks-i ndeshet me Indiana Pacersin.

SHKURT

Batatina për Cernavernin: Së shpejti do ta pushtoj Evropën

Tahir Batatina, trajneri i Llapit, e ka vlerësuar lart një tjetër talent të skuadrës së tij, sipas të cilit, ai do ta "pushtojë" Evropën në të ardhmen e afërt. Është fjala për futbollistin Mërgim Cernavernin, i cili është vlerësuar shumë nga Batatina. Tahir Batatina në "Facebook" ka shkruar se Kosova do të mund të llogarisë në shërbimet e tij. "Kosova mos të brengoset sepse një tjetër talent dhe sulmues do ta ketë së shpejti në gjirin e vet dhe së shpejti do ta pushtojë Evropën", ka shkruar Batatina.

Formula 1 zyrtarizon garat sprint për vitin 2024

Edhe vitin 2024 do të jenë gjashtë garat sprint që do të zhvillohen përgjatë gjithë sezonit. Lajmin e zyrtarizoi Formula 1, që konfirmoi edhe pistat ku do të garohet si ditën e shtunë ashtu dhe ditën e diel. Garat sprint do të zhvillohen në Kinë, Majemi, Austri, Amerikë, Brazil dhe Katar. Për garën e Austrisë (pista e Spielberg) dhe atë të Brazilit (pista e San Paolo), kjo është hera e tretë që organizojnë garën sprint. Për pistat e Austin (Amerikë) dhe Losail (Katar) do të jetë hera e dytë si dhe hera e parë për garat e Kinës dhe Majemit. Garat sprint, të gjata 100 km, organizohen për t'i dhënë më shumë argëtim publikut. Pilotët që renditen në tetë vendet e para marrin pikë në garën sprint. Edhe këtë vit garat sprint ishin gjashtë, një risi kjo që është aplikuar për herë të parë në vitin 2021.

Balotelli: Italia i frikëson të gjithë

Italia mësoi para pak ditësh kundërshtarët në "Euro 2024". Goglat i rezervuan kundërshtarë mjaft të vështirë. Kombëtarja e drejtuar nga Spalletti do të përballet me Spanjën, Shqipërinë dhe Kroacinë. Ish-sulmuesi i njohur i "Axurrëve", Mario Balotelli, ka dhënë mendimin e tij për shortin. "Të gjithë atyre që mendojnë se Italia do të kthehet në shtëpi që në grup, i këshilloj të mos e shohin. Italia i frikëson gjithmonë të gjithë. Ma besoni që në Spanjë dhe në Kroaci nuk janë aspak të lumtur që do të përballet me ne. Megjithatë, është ende herët për t'u shqetësuar. Grupi është i një niveli të lartë, por mund t'ia dalim", ka deklaruar Balotelli.

Ter Stegen do t'i nënshtrohet operacionit

Portieri i Gjermanisë dhe Barcelonës, Marc-Andre ter Stegen, ka vendosur të bëjë një operacion për t'u dhënë fund problemeve me shpinën, raporton "SPORT". Ter Stegen zgjodhi të bëjë ndërhyrje, e cila do të kryhet në ditët në vijim. Ter Stegeni do të mungojë për dy deri në tre muaj dhe është në dyshim për fazën e 1/16 të Ligës së Kampionëve. Objektivi i klubit është që Ter Stegen të jetë i disponueshëm për ndeshjen e parë me eliminim direkt të kompeticionit më të rëndësishëm evropian të planifikuar për në shkurt. "Gardiani" do ta humbasë Superkupën e Spanjës, disa ndeshje të kampionatit dhe "play-off"-et e Copa del Rey. Megjithatë, siç mësojmë nga gazeta spanjolle, porta do t'i besohet Inaki Penas.

Reali më 1 janar fillon operacionin për transferimin e Mbappes

Te Real Madridi askush nuk shprehet me zë të lartë rreth objektivit për të nënshkruar me Kylian Mbappen. Edhe pse e vërteta është se ambienti madrilen "zien" përbrenda dhe

pret me padurim fundin e vitit. Spanjollët shpresojnë që sulmuesi të rezistojë pa rinovuar kontratën deri me 31 dhjetor të këtij viti e më pas me 1 janar mund të nisë sulmin e plotë për t'i siguruar

shërbimet e 25-vjeçarit. Kontrata e Mbappes skadon në qershor të vitit 2024 dhe në këtë formë, prej 1 janarit, madrilenët lejojnë t'i hapin negociatat me lojtarin në fjalë pa rrezikuar një ankesë të

Paris Saint-Germain në organet e UEFA-s. Plani i Realit nga ana tjetër është i qartë: t'i prezantojë Mbappes ofertën dhe t'i vendosë sulmuesit një limit dyjavor. Nëse Kampioni i Botës me Francën nuk

e ndan mendjen brenda dy javësh, atëherë historia merr fund njëherë e përgjithmonë dhe Reali do ta kalonte fokusin te të tjerë futbollistë duke nisur me Erling Haaland.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Rudy's Pizza” Sh.P.K., ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812063634 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Rudy's Pizza” D.O.O., donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812063634 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Rudy's Pizza” L.L.C, has come to the decision to quit its business: 812063634 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



NJOFTIM PËR KONTRATË

*Tenderi
(Shërbim)*

Në përputhje me ‘Rregulla t e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Shtator 2021)’

- I** Numërtimi i Prokurimit: BQK 23 060 221
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës – BQK
- II** LËNDA E KONTRATËS
II.1.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja: “Shërbimet e mirembajtjes dhe servisit të makinave procesuese”
- III** VENDI I REALIZIMIT
III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së , rr. “Garibaldi” nr. 33, 10000 Prishtinë.
- IV** KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS
IV.1 “Tenderi i përshatshëm me çmimin më të ulët” (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në www.bqk-kos.org/shpallje/tenderi)
- V** INFORMATA ADMINISTRATIVE
V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata tjera:
Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 18.12.2023 ora 14:00 në e-mail adresën prokurimi@bqk-kos.org
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 18.12.2023 ora 14:00
V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve:
Adresa: në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë:
Data: 20.12.2023, ora 14:00.
V.3 Sigurimi i tenderit: 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite.
V.4 Sigurimi i kontratës: 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 24 muaj që nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
V.5 Takimi për hapjen e tenderëve:
Data: 20.12.2023, ora 14:30. Vendi: Objekti i BQK-së, Rr. “Garibaldi” nr. 33., Prishtinë.
- VI** INFORMATA PLOTËSUESE
VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë në dispozicion në: www.bqk-kos.org
- VII** ANKESAT
Në përputhje me ‘Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës’, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë BQK-së brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve kalendarikë nga shpallja e njoftimit përkatës.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Garibaldi 33, 10000 Prishtinë
www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Apollonia 1991 1” SH.P.K. me numër të biznesit, numër UNIK: 811450709, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit
- Biznesi “Metaj & Gashi Real Estate” Sh.P.K me adresë në Prishtinë, rruga “Muharrem Fejza” shpall të pavlefshme certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues: 811958422
- Osman Zeka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Mimoza Bibaj komuna e Malishevës, shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Skyfer Haxhija nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.
- Vjollca Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl.I sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë drejtimi Juridik.
- Arbnor Dervishaj shpall të pavlefshme dëftesat Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Naim Hasani shpall të pavlefshme diplomën Q.K.”11 Marsi” Prizren.
- Lavdim Ibrahim shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra “Qerimi2”, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për



Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik Nr.07/2017, Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë, shpallë:

K O N K U R S

(Për plotësimin e vendeve të punës, punë provuese gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi)

I. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier përgjegjës- Hidroteknikë

Përgatitja profesionale: Fakulteti Teknik - Hidroteknikë

Përvoja e punës: 2 vite e preferueshme

Numri i kryerësve: (2)

Koeficienti i pagës: 632.39 Euro

Aftësitë e buta: aftësitë e mira të komunikimit, etikën e punës, punën ekipore, vendimmarrjen, menaxhimin e kohës, motivimin, fleksibilitetin, zgjidhjen e problemeve dhe mendimin kritik.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Punon në kalkulimin e çmimeve për paramasë dhe parallogaritë e po ashtu edhe përgatit apo kompletion dokumentet për projektet e ujësllësit (kompletimin e tenderit)
- Bashkëpunon me shërbimet dhe departamentet tjera e sidomos me zyrën e GIS-it në KRU Mitrovica,
- Pas kordinimit të punëve në zyre, të planifikimit dhe punimit të projekteve sipas kërkesës së shërbimeve obligohet të përcjell zhvillimet e punimeve edhe në teren,
- Përgatit tërë dokumentacionin teknik për kryerjen e punëve dhe të njejtin ia dërgon Shefit të shërbimit të projektimit dhe zyrës së GIS-it.
- Bashkëpunon dhe koordinon punën me stafin inxhinierik dhe GIS në hartimin e projekteve investive në fushën e Hidroteknikës.
- Bënë mbikëqyrjen e implementimit të projekteve.
- Për mirëmbajtjen dhe operimin e rregullt të asetëve të kompanisë bën plane për tu përgjigjur në çdo sfidë siç janë planet pro aktive, reaktive dhe preventive/parandaluese.
- Bënë planin e punës, planin vjetor dhe të remonteve të mirëmbajtjes së objekteve në pikëpamje investive dhe të rregullt nëse është e aplikueshme duke paraparë materialin e nevojshëm dhe pjesët e ndërrimit
- Formon dokumentacionin e rregullt dhe kujdeset për ruajtjen e tij;
- Është përgjegjës ndaj ligjeve shtetërore që rregullojnë veprimtarinë nga lëmitë e profileve të këtij shërbimi dhe kujdeset që ti marrë masat gjegjëse sidomos nga mbrojtja higjieno - teknike dhe të mbrojtjes në punë;

- Evidenton defektet dhe dëmtimet në rrjetin e ujësllësit në pronësi të KRU-së deri te prona e konsumatorit, dhe merr masa preventive që me kohë të eliminohen këto defekte dhe dëmtime deri në funksionimin e rregullt të rrjetit që furnizon konsumatorët e tërë rrjetit, si dhe pas evidentimit i rexhistron ato në sistemin GIS
- Përpilon planin e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë si dhe zgjerimin e rekonstruimin e objekteve të KRU-së, në mënyrë që të sigurohet funksionaliteti dhe efikasiteti i plotë i punës së tij;
- Në kuadër të vet dhe në kuadër tjetër plotësues projekton objekte hidroekonomike dhe hidrondërtimore për Kompaninë dhe për palët e treta dhe me mjetet e veta ose plotësuese i realizon ato kur të sigurohen mjetet financiare;
- Pranon punë dhe përgjegjësi të tjera nga udhëheqësit konform nevojave të kompanisë.
- Kryen punë të tjera dhe i raporton Shefit të shërbimit dhe Menaxherit të Departamentit.

II. Emërtimi i vendit të punës: Inxhinier/e i/e Elektronikës

Përgatitja profesionale: Fakulteti Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike –Bachelor Elektronikës

Përvoja e punës: Së paku 1 vit

Numri i kryerësve: (1)

Koeficienti i pagës: 632.39 Euro

Kushtet të veçanta: - Aftësi të shkëlqyeshme komunikimi dhe bashkëpunimi me Menaxhmentin e Kompanisë.

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i/e aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat,
- Është përgjegjës për organizimin e mirëmbajtjes në sektorin e Elektros të pajisjeve në Impiante, stacionet e pompave, rezervuarëve të ujit dhe pajisjeve të tjera elektrike dhe automatike në nivel të kompanisë.
- Planifikon mbikëqyrjen javore të gjitha stabilimenteve në fabrikë si dhe stacioneve të pompave,
- Bënë planifikimin e materialit rezervë për mirëmbajtje,
- Është i obliguar që të merret me kualifikimin dhe harmonizimin e dokumentacionit teknik në të gjitha objektet në nivel të kompanisë,
- Përshtat sistemet e reja elektrike dhe automatike në nivel të ujësllësit si dhe harton udhëzimet për punë dhe kryerjen e punëve si dhe montimin e pajisjeve të reja,
- Harton raporte të punës periodike në sektorin e elektros,

- Përgatit manuale për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektrike, elektronike dhe automatike të cilat duhet të jenë në dispozicion për personelin i cili operon me aparaturën përkatëse,
- Mirëmban pajisjet elektrike-automatike sipas kritereve teknike të prodhuesit dhe mban shënime të rregullta të mirëmbajtjes së tyre,
- Bashkëpunon me Menaxherët dhe Inxhinierët tjerë,
- Kryen edhe punë tjera të fushës përkatëse sipas urdhrit të Udhëheqësit/es,
- Për punën që kryen i përgjigjet Inxhinierit/es përgjegjës të Elektroenerxhetikës.

Dokumentet e kërkuara:

Kandidatet e interesuar duhet të plotësojnë aplikacionin e Kompanisë dhe së bashku me këtë aplikacion të bashkangjesin edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Letër motivimi,
- Diploma e Universitare (kopja e noterizuar, kurse diploma nga universiteti jashtë vendit duhet të jetë e nostrifikuar),
- Dëshmi nga gjykata kompetente që nuk është nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj,
- Dëshmitë e përgatitjes profesionale,
- Dëshmi mbi eksperiencën e punës,
- Kopja e letërnjoftimit.

Mënyra e aplikimit:

- Aplikacionet mund të merren ueb-faqen e Kompanisë KRU "Mitrovica" Sh.A. në adresën: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset> si dhe fizikisht në zyrën për Burime Njerëzore, dhe të dorëzohen në të njëjtën zyre së bashku me dokumentacionin përcjellës në formë fizike.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga dita e publikimit nga data 07.12.2023 deri me datën 21.12.2023.
- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.
- Dokumentet e pranura të aplikantëve në fotokopje nuk kthehen.
- Kompania Rajonale Ujësllësi "Mitrovica" Sh.A. në Mitrovicë inkurajon kandidatet femra, kandidatët nga grupet minoritare si dhe personat me aftësi të kufizuara të aplikojnë.

VËREJTJE: Kandidatët të cilët paraqesin aplikacionin e pa-plotësuar, apo nuk i bashkëngjisin dokumentet e kërkuara si në konkurs, aplikimet e tyre do të refuzohen dhe të njëjtin nuk do të i nënshtrihen procedurës së rekrutimit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgatitjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregatitje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË



U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212 i Administrativnog uputstva za regulisanje tenderskih postupaka u javnom sektoru br. 07/2017, Regionalno vodovodno preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici, je objavila ovaj:

OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

(Za popunjavanje slobodnih radnih mesta šest (6) meseci probni rad sa mogućnošću produženja)

I. Naziv radnog mesta: Odgovorni inženjer- Hidrotehnika

Profesionalna kvalifikacija: Tehnički Fakultet - Hidrotehnika

Radno iskustvo: 2 godine poželjno

Broj pozicija: (2)

Koeficijent plate: 632.39 €

Meke veštine: dobre komunikacijske veštine, radna etika, timski rad, donošenje odluka, upravljanje vremenom, motivacija, fleksibilnost, rešavanje problema i kritičko razmišljanje.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Radi na kalkulaciji cena za predmere i predračune i priprema ili kompletira dokumentaciju za projekte vodosnabdevanja (kompletiranje tendera),
- Saraduje sa drugim službama i odeljenjima, posebno sa GIS kancelarijom u RVP Mitrovica,
- Nakon koordinacije rada u kancelariji, planiranja i rada na projektima po zahtevu službi, zaposleni je dužan da prati razvoj radova na terenu,
- Priprema svu tehničku dokumentaciju za izvođenje radova i šalje je šefu projektantske službe i GIS kancelariji,
- Saraduje i koordinira rad sa inženjerskim i GIS kadrom na projektovanju investicionih projekata iz oblasti hidrotehnike,
- Nadzire realizaciju projekata,
- Za održavanje i redovno funkcionisanje imovine kompanije, zaposleni planira da odgovori na svaki izazov, kao što su reaktivni, proaktivni i preventivni planovi,
- Priprema plan rada, godišnji plan i plan sanacije i održavanja objekata u smislu investicionog i redovnog održavanja, po potrebi, uključujući planiranje potrebnog materijala i rezervnih delova,
- Izrađuje redovnu dokumentaciju i stara se o njenom očuvanju,
- Odgovoran je za državne zakone koji regulišu delatnost u oblastima profila ove službe i stara se o preduzimanju odgovarajućih mera, posebno u pogledu higijensko – tehničke zaštite i zaštite na radu,
- Identifikuje kvarove i oštećenja na vodovodnoj mreži u vlasništvu RVP do imovine potrošača i preduzima preventivne mere za otklanjanje ovih kvarova i oštećenja na vreme dok ne obezbedi uredan rad mreže koja snabdeva potrošače cele mreže, uključujući i njihovu registraciju u GIS sistemu,
- Priprema srednjoročni i dugoročni plan razvoja, kao i proširenja i rekonstrukcije objekata RVP, kako bi se obezbedila puna funkcionalnost i efikasnost njegovog rada,
- U okviru poslova i drugih komplementarnih okvira projektuje hidro-privredne i hidrograđevinske objekte za Preduzeće i za treća lica i sopstvenim ili komplementarnim sredstvima ih izvodi kada su obezbedena finansijska sredstva,
- Prihvata radne i druge obaveze od rukovodilaca prema potrebama kompanije,
- Obavlja i druge poslove i izveštava šefu službe i rukovodioca odeljenja.

II. Naziv radnog mesta: Inženjer elektrotehnike

Profesionalna kvalifikacija: Elektrotehnički i računarski fakultet – Diplomirani Inženjer elektrotehnike

Radno iskustvo: Najmanje 1 godina

Broj pozicija: (1)

Koeficijent plate: 632.39 €

Posebne veštine: - Odlične veštine komunikacije i saradnje sa menadžmentom kompanije.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- U stanju je da obavlja zadatke sa punim radnim vremenom i bez ograničenja,
- Odgovoran je za organizaciju održavanja u sektoru elektrotehnike koji se odnosi na opremu u postrojenjima, pumpnim stanicama, rezervoarima za vodu i drugu elektro i automatsku opremu na nivou preduzeća.
- Planira nedeljni nadzor svih objekata u fabrici kao i pumpnih stanica,
- Pravi planiranje rezervnog materijala za održavanje,
- Obavezuje se da se bavi kvalifikacijom i usaglašavanjem tehničke dokumentacije u svim objektima na nivou preduzeća,
- Osposobljen je za adaptaciju novih elektro i automatskih sistema na nivou vodovoda, kao i izradu uputstva za rad i izvođenje radova, kao i montažu nove opreme,
- Izrađuje periodične izveštaje o radu u sektoru elektrotehnike,

- Priprema priručnike za upotrebu i održavanje električne, elektronske i automatske opreme koji moraju biti dostupni osoblju koje upravlja odgovarajućom opremom,
- Održava elektro-automatsku opremu prema tehničkim kriterijumima proizvođača i vodi redovnu evidenciju o njihovom održavanju,
- Saraduje sa drugim menadžerima i inženjerima,

- Obavlja i druge poslove iz odgovarajuće oblasti po nalogu rukovodioca,
- Za poslove koje obavlja odgovoran je odgovornom inženjeru elektrotehnike.

Potrebna dokumentacija:

Zainteresovani kandidati moraju popuniti prijavu Preduzeća i uz prijavu priložiti sledeću dokumentaciju:

- CV (Biografija),
- Motivaciono pismo,
- Univerzitetska diploma (overena kopija, dok diploma sa univerziteta u inostranstvu mora biti nostrifikovana),
- Dokaz nadležnog suda da nije pod istragom, ne stariji od 6 meseci,
- Dokaz o stručnom usavršavanju,
- Dokaz o radnom iskustvu,
- Kopija lične karte.

Način prijave:

- Prijave se mogu dobiti na sajtu Preduzeća RVP „Mitrovica“ d.d. na adresi: <http://www.kru-mitrovica.com/konkurset>, kao i fizički u Službi za ljudske resurse, i dostaviti istoj kancelariji zajedno sa pratećom dokumentacijom u štampanom obliku.
- Konkurs će biti otvoren 15 dana od dana objavljivanja od **07.12.2023 do 21.12.2023**.
- Prijave dostavljene nakon isteka roka se ne prihvataju.
- Prihvaćena dokumenta podnosiocima prijava u fotokopijama se ne vraćaju.
- Regionalno Vodovodno Preduzeće „Mitrovica“ d.d. u Mitrovici podstiče kandidatkinje, kandidate iz manjinskih grupa, kao i osobe sa invaliditetom da se prijave.

NAPOMENA: Kandidatima koji podnesu nepotpunu prijavu, ili ne prilože traženu dokumentaciju kao u oglasu za konkurs, prijave će biti odbijene i neće biti predmet postupka prijema.

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrapa Teatrit, 4 Shullat, Rr. Bajram Kelmendi

